



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 11267 Prot

Lezhë, më 31 /07 /2023

VENDIM

Nr. 16, Datë 27. 07. 2023

**Për përdorimin e Fondit të Kontigjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2023**

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit Nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të VKM nr.288, datë 17.05.2023 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit \*Ndërtimi i rrugës Shëngjin-Baks-Rrjoll, segmenti nga km +0.00 deri në km 7 + 310\*”, pika 5, dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

**Vendosi :**

1.Miratimin e përdorimit të Fondit të Kontigjencës në shumën 50,000 lekë, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2023, për këtë të kryhen veprimet si më poshtë:

- Pakësohet : Gr.00, Prog.04940, Kap.01, Art.609 për shumën 50,000 lekë.
- Shtohet : Gr.00, Prog.01110, Kap.01, Art.602 për shumën 50,000 lekë, fond i cili do të përdoret për mbulimin e shpenzimeve proceduriale.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

CB  
Nr. 11267/1. prot  
Dt. 3.8.2023.

Nr. 585/6 Prot.

Lezhë, më 03.08.2023

Lënda: Konfirmim vendimi

### KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr. 107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, VKM-nw nr. 288, datë 17.5.2023 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "ndërtimi i rrugës shëngjin-baks-rrjoll, segmenti nga km + 0.00 deri në km 7 + 310" si dhe Udhezimit të Ministrisë së Financave dhe ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 16, datë 27.07.2023 të Këshillit të Bashkisë Lezhë, "Për përdorimin e fondit të kontigjencës për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2023".

PREFEKTI

Gjergj PRENDI

